




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 03-02/DPK	Nr Prot Br Prot Prot No 01-1406/16
Nr. i faq Broj stranica 03	Data Datum Date 07-04-2016
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07.04.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK/1242/16
PËR/ZA/TO:	z. Osman Bllaca, Auditor i i Brendshëm, në Komunën e Prishtinës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

E nderuar z. Bllaca ,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, duke u bazuar në pyetjen e regjistruar me numër protokollit AKK-03-02/1242/16, nga z. Osman Bllaca, Auditor i Brendshëm, në Komunën e Prishtinës, ku ka kërkuar për ti dhen një opinion lidhur me sqarimin e situatës që ndërlidhet me punën e tij gjegjësisht funksionin si Auditor i Brendshëm, në Komunën e Prishtinës, dhe emërimit të tij si anëtar Komisionit Disiplinor në kuadër të Komunës së Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit duke u bazuar ne mandatin qe ka ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksionit publik si Auditor i Brendshëm, në Komunën e Prishtinës dhe emërimi në Komisionin Disiplinor në kuadër të Komunës së Prishtinës, nuk cilësohet si konflikt i interesit, mirë po nëpunësit civil të administratës së komunës duhet ta kenë parasysh konfliktin e interesit rast pas rasti.

Arsyetim

Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik . Në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paaanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”, ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji. Rrjedhimisht në këtë nen janë paraparë edhe Auditorët e Brendshëm .

Duhet ditur se është obligim i çdo zyrtari që të respektoj të gjitha ligjet në fuqi, andaj është obligim i juaj si zyrtarë që të respektoni dhe të zbatoni, ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në të cilin ndër të tjera përcaktohen detyrimet e nëpunësve civil.

Në bazë të nenit 5 (paragrafi 8) të këtij ligji parashihet se nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt të interesit.

Ndërsa në bazë të nenit 7.6 të ligji Nr. 04/L-051 thuhet se : Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejtë të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.

Po ashtu edhe në pikën 8 të këtij neni zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai

është real, apo i mundshëm, ndërsa sipas nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë kanë detyrë që të parandalojnë konfliktin e interesit dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Ne Ligjin Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale është parapa dispozita e veçantë nenin 67 ku thuhet se : Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

Duke u bazuar ne gjithë atë që u tha me lartë mundë të themi se emërimi i juaj si Anëtarë i Komisionin Disiplinor në Komunën e Prishtinës, gjatë kohës sa ushtroni funksionin e Auditorit të Brendshëm në këtë Komunë, sipas dispozitave ligjore ne fuqi nuk konsiderohet si konflikt i interesit, mirë po ju si nëpunës civil i administratës së komunës dhe zyrtari lartë sipas ligjit në fuqi duhet ta kenë parasysh konfliktin e interesit rast pas rasti, i cili mundë te shfaqet ne situata të veçanta.

Me respekt!

